



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 1495 Prot.

Tiranë, më datë 01.12.2023

VENDIM
Nr. 594, datë 01.12.2023

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saq”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 01.12.2023:

VENDOSI:

- Miratimin e kërkesës së subjektit “**Lior Construction**” sh.p.k për pajisje me Licencë për personin juridik (N) në zbatim (Z) në veprimtari ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale, në kategoritë (A), me drejtues teknik Z. *Dorian Ceribashi*, në nënkategoritë:
 - N - Z/A/2. Zbatim në konservim dhe restaurim i ndërtimeve me karakter mbrojtës;
 - N - Z/A/5. Zbatim në konservim dhe restaurim i arkitekturës së traditës (vernakulare);
 - N - Z/A/6. Zbatim në konservim dhe restaurim i arkitekturës së projektuar;
 - N - Z/A/7. Zbatim në konservim, restaurim dhe rikualifikim i hapësirave (rrugë, sheshe) brenda qendrave historike dhe ansambleve historike urbane;
- Mosmiratimin e kërkesës së subjektit “Lior Construction” sh.p.k për pajisje me Licencë për personin juridik (N) në zbatim (Z) në veprimtari ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale, në kategoritë (A), për nënkategoritë; Z/A/1, Z/A/3, Z/A/4, sipas pikës 2), gërma “b” në “Kriteret e posaçme për licencim për personin fizik/juridik” të V.K.M. Nr. 792, datë 07.12.2023 “ Për përcaktimin e kushteve dhe të kriterëve të posaçme të licencimit, dokumenteve shoqëruese, nënkategorive të licencave, procedurave për dhënien, pezullimin ose revokimin, si dhe kuotizacionit vjetor të licencave për ndërhyrjet në pasuritë kulturore materiale”, i ndyshuar;
- Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi;
- Kundër këtij vendimi mund të ushtrohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Klesta QIRICI

